



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

V E N D I M

Nr. 572, datë 20.11.2020

PËR

VERIFIKIMIN E PLOTËSIMIT NGA KANDIDATJA ZNJ. {...} TË TRE KRITEREVE TË KANDIDIMIT PËR NGRITJEN NË DETYRË NË GJYKATËN ADMINISTRATIVE TË APELIT, PËR POZICIONIN E LIRË TË SHPALLUR ME VENDIMIN E KËSHILLIT NR. 187, DATË 28.05.2020, TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR DHE VIJIMIN E PROCEDURËS SË VERIFIKIMIT PËR KRITERET E TJERA LIGJORE TË KANDIDIMIT

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 20.11.2020, pasi u njoh me materialet e çështjes dhe Relacionin “Për gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e tre prej kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën Administrative të Apelit, të kandidatës znj. {...}”, përgatitur nga relatorja znj. Marçela Shehu, si dhe pasi shqyrtoi propozimin për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 187, datë 28.05.2020, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale” dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit,

V Ë R E N

I. PROCEDURA E VERIFIKIMIT

1. Me Vendimin nr. 180, datë 28.05.2020 “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Tiranë në fushën e të drejtës civile”, Këshilli i Lartë Gjyqësor (më poshtë referuar si Këshilli) ka vendosur:

“1. Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile...”

3. Afati i kandidimit është dy javë nga dita e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të njoftimit për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë....”

2. Me Vendimin nr. 187, datë 28.05.2020 “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës Administrative të Apelit”, Këshilli i Lartë Gjyqësor (më poshtë referuar si Këshilli) ka vendosur:

“1. Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës Administrative të Apelit....

3. Afati i kandidimit është dy javë nga dita e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të njoftimit për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë....”.

3. Me Vendimin nr. 188, datë 28.05.2020 “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës Administrative të Apelit”, Këshilli i Lartë Gjyqësor (më poshtë referuar si Këshilli) ka vendosur:

“1. Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës Administrative të Apelit....

3. Afati i kandidimit është dy javë nga dita e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të njoftimit për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë....”.

4. Njoftimi për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë për këto pozicione të lira është publikuar në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, më datë 29.05.2020, duke përfunduar kështu afati i kandidimit më datë 15.06.2020.

5. Brenda afatit të kandidimit ka kandiduar edhe znj. {...} (më poshtë referuar si kandidati), aktualisht gjyqtare pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

6. Me Vendimin nr. 238, datë 07.07.2020, “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe në Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor të datës 28.05.2020”, Këshilli ka vendosur:

“1. Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe në Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet nr. 173, nr. 174, nr. 176, nr. 179, nr. 180, nr. 181, nr. 182, nr. 183, nr. 184, nr. 185, nr. 186, nr. 187 dhe nr. 188, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Caktimin e relatorit për secilin kandidat, si më poshtë: ...

...3. Për kandidaten znj. {...} - relatore znj. Marçela Shehu; ...”.

7. Më datë 07.07.2020, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në Seksionin A, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, në rrugë elektronike, kandidatja u njoftua:

- për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit;
- për caktimin e relatores së kësaj procedure verifikimi;
- për të drejtën që kishte për të kërkuar përjashtimin e relatores së caktuar dhe/ose të çdo anëtari tjetër të Këshillit, brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e këtij njoftimi.

8. Brenda afatit të përcaktuar kandidatja nuk parashtrori ndonjë pretendim në lidhje me relatoren e caktuar për procedurën e verifikimit ndaj saj apo për ndonjë anëtar tjetër të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

9. Në lidhje me verifikimin e pasurisë dhe të figurës së kandidatës, në kuadër të ngritjes në detyrë, në kushtet kur kandidatja është subjekt rivlerësimi “*ex officio*” sipas Ligjit nr. 84/2016 “Për procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, proces ky që për kandidaten nuk ka përfunduar, referuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në Ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në pikën 2¹, Seksioni B, Kreu X, të Vendimit 75/2019, Këshilli i Lartë Gjyqësor, me Shkresën nr. 3118 prot., datë 09.07.2020, i ka kërkuar Komisionit të Pavarur të Kualifikimit trajtimin me përparësi të procedurës së rivlerësimit kalimtar ndaj kandidatës, verifikim që po vijon në bazë të përgjigjes, me shkresën nr. 4692/1 prot., datë 17.07.2020, të këtij Institucioni.

10. Më datë 09.07.2020, bazuar në pikën 8, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, në rrugë elektronike, kandidatës iu dërguan formularët dhe autorizimet përkatëse (të përcaktuara në pikën 6, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019) që duhet të plotësoheshin dhe dorëzoheshin prej saj në kuadër të procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit.

11. Brenda afatit pesëditor, kandidatja depozitoi rregullisht dokumentacionin e kërkuar të kandidimit, pranë Zyrës së Protokollit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, ndërsa një nga dokumentet, pikërisht formularin e deklaratës së pasurisë, sipas Vendimit 75/2019, kandidatja duhet ta dorëzonte, jo më vonë se 21 ditë nga dita e dërgimit të tij, pra deri më datë 09.07.2020, pranë ILDKPKI-së.

12. Në vijim të procedurës së verifikimit, më datë 19.05.2020, bazuar në pikën 10, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, përmes shkresave të veçanta, u kërkuar informacion dhe raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës, për kandidatët për gjyqtar në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe në Gjykatën Administrative të Apelit, ndër ta edhe për kandidaten znj. {...}. Për këto kriterë ligjore kandidimi procedura e verifikimit është në proces e sipër.

13. Ndërkohë, kandidatja znj. {...} ka kandiduar edhe *për dy pozicione të lira në fushën e të drejtës administrative në Gjykatën e Lartë, të shpallura me Vendimet nr. 84, datë 26.02.2020 dhe nr. 245, datë 09.07.2020, në total për 5 (pesë) pozicione të lira që janë në proces ku përfshihen dhe tre pozicione të lira në Gjykatën e Apelit Tiranë dhe në Gjykatën Administrative të Apelit, të shpallura respektivisht me Vendimet nr. 180, nr.187 dhe nr. 188, datë 28.05.2020;*

¹ “Kandidatët që i nënshtrohen procedurës së rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr.84/2016 dhe janë në procedurë e sipër rivlerësimi ose për të cilët kjo procedurë nuk ka filluar ende, nuk i nënshtrohen procedurës së verifikimit të pasurisë dhe të figurës nga Këshilli, sipas përcaktimeve të pikave 2 deri në 7, të nenit 32, të Ligjit për Statusin. Vendimi i Këshillit për kualifikimin ose jo për këta kandidatë do të mbështetet në vendimin e dhënë nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit. Në këtë rast, Këshilli i kërkon Komisionit të Pavarur të Kualifikimit trajtimin me përparësi të procedurës së rivlerësimit për këta kandidatë. Nëse Komisioni i Pavarur i Kualifikimit nuk i përgjigjet kërkesës së Këshillit ose nuk përfundon procedurat e rivlerësimit për këta kandidatë brenda 3 muajve nga momenti i paraqitjes së kërkesës, këta kandidatë i nënshtrohen procedurës së verifikimit të pasurisë dhe të figurës sipas përcaktimeve të pikave 2 deri në 7, të nenit 32, të Ligjit për Statusin”

14. Këshilli i Lartë Gjyqësor me Vendimin nr. 268 datë 07.08.2020 “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për kandidatët nga radhët e gjyqtarëve, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 84 dhe nr. 87 datë 26.02.2020 si dhe vendimet nr. 241, nr. 242, nr. 243, nr. 244 dhe nr. 245 datë 09.07.2020 Këshilli ka vendosur:

1. *Fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për kandidatët nga radhët e gjyqtarëve që kanë aplikuar për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet nr.84 dhe nr.87, datë 26.02.2020 (në fushat e të drejtës administrative dhe të së drejtës civile), me Vendimet nr.241, nr.242, nr.243 dhe nr.244, datë 09.07.2020 (në fushën e të drejtës penale), si dhe me Vendimin nr.245, datë 09.07.2020 (në fushën e të drejtës administrative), të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Caktimin e relatorit për secilin kandidat, si më poshtë:*
 1. *Për kandidaten znj. {...} - relatore znj. Marçela Shehu..*

15. Në vijim të procedurës së verifikimit, bazuar në pikën 6, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, përcaktohet se: “Pas shpalljes së procedurës së ngritjes në detyrë, kandidati mund të kandidojë për jo më shumë se tre pozicione të lira ose pozicione që priten të bëhen të lira. Nëse magjistrati kandidon për më shumë se një pozicion, ai bën renditjen e tyre sipas preferencës”, në interpretim dhe zbatim të kësaj dispozite ligjore, sikurse është bërë me dije në rastet e njoftimeve të shpalljes së procedurave të ngritjes në detyrë në një gjykatë më të lartë ose të specializuar/posaçme, por edhe të praktikës së deritanishme, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka konsideruar se:

- *Në procedurat e ngritjes në detyrë në një gjykatë më të lartë ose të specializuar mund të kandidojë çdo gjyqtar që plotëson kriteret ligjore, pavarësisht faktit nëse ka kandiduar në procedura të mëparshme ngritjeje në detyrë.*
- *Në çdo rast, kandidati nuk mund të kandidojë në më shumë se tre pozicione të lira që janë në proces, pavarësisht kohës së shpalljes së tyre, qenies së tyre në të njëjtën gjykatë apo në të njëjtën fushë të së drejtës.*
- *Në rast të kandidimit në më shumë se tre pozicione të lira në proces, kandidati duhet të rikonsiderojë kandidimet e tij, për të përcaktuar tre pozicionet për të cilat vijon kandidimin. Mospërcaktimi i tyre nga vetë kandidati, passjell identifikimin e vullnetit të tij në bazë të kohës së kandidimeve, duke filluar nga ai i bërë më parë ose në rastin e shumë kandidimeve në të njëjtën kohë, në bazë të radhës kronologjike të pozicioneve të shpallura, duke filluar nga ai i shpallur më parë.*
- *Kandidimi për një pozicion të lirë për të cilin procedura e ngritjes në detyrë është finalizuar/përmbyllur dhe kandidimi i tërhequr, nuk llogariten si kandidime për efekt të të drejtës së kandidimit në jo më shumë se tre pozicione të lira.*

Në kushtet kur kandidatja ka kandiduar për më shumë se tre pozicione të lira në proces, ndërsa ligji kufizon të drejtën e kandidimit deri në tre të tillë, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, më datë 04.08.2020, e njoftoi elektronikisht duke e ftuar kandidaten të rikonsideronte kandidimet e saj, për të përcaktuar tre pozicionet për të cilat do të vijonte kandidimin.

16. Po në rrugë elektronike, me datë 04.08.2020, kandidatja znj. {...} ka konfirmuar tërheqjen nga kandidimi për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 180 datë 28.05.2020, duke shprehur se: “... referuar dhe nenit 48 të ligjit me Nr.96/2016, përzgjedh 3 pozicione ku kandidoj, si vijon:

Dy pozicionet e shpallura të lira në Gjykatën e Lartë, fusha e së drejtës administrative, për të cilët kam paraqitur dhe kërkesat përkatëse. Pozicionin e shpallur të lirë në Gjykatën Administrative të Apelit, që do mbetet për vijimin e procedurës së ngritjes në detyrë, pasi kam ardhur në dijeni se, në një nga pozicionet është caktuar z. Dvorani.

Heq dorë nga kërkesa për kandidim në pozicionin e shpallur në Gjykatën e Apelit Tiranë, fusha civile dhe nga kërkesa për kandidim në pozicionin e shpallur në Gjykatën Administrative të Apelit, por që është caktuar më pas, z. Dvorani. Ju kërkoj ndjesë, që nuk kam përcaktuar këtë të fundit me Numë Vendimi të KLGJ-së për shpallje pozicioni, pasi jam në pamundësi objektive t'a përcaktoj. Megjithatë, mendoj se vullneti im për vazhdimin e konkurrencimit dhe përzgjedhjen e 3 pozicioneve shprehet qartë dhe në këtë formë...”;

17. Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në pikën 2, të nenit 64, të Kodit të Procedurave Administrative, në pikën 3, të nenit 97, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe në pikën 6, Seksioni B, Kreu V, të Vendimit të tij nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, pasi shqyrtoi kërkesën e kandidatës për tërheqjen nga kandidimi në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin nr. 288, datë 08.09.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, mbi propozimin e relatores së çështjes, ka vendosur :

- 1. Përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin nr. 180, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidaten znj. {...}, për shkak të tërheqjes së saj nga kandidimi për këtë pozicion.*

18. Sa sipër kandidatja znj. {...} duhet të vlerësohet në lidhje me tre kriteret formale të kandidimit të saj për ngritjen në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit, për njërin nga pozicionet e lira të shpallura me Vendimet e Këshillit nr. 187 ose nr. 188, datë 28.05.2020

19. Rezulton se në Mbledhjen Plenare të datës 07.10.2020, Këshilli ka miratuar edhe Vendimin nr. 398, “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë pranë Gjykatës Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr. 188, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, si më poshtë :

- 1. Përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë pranë Gjykatës Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr. 188, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Kandidimi i gjyqtarit në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 188 datë 28.05.2020, konsiderohet si kandidim në procedurën e ngritjes në detyrë pranë Gjykatës Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 187 datë 28.05.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Ky vendim u njoftohet gjyqtarëve ... {...} që kanë kandiduar për ngritjen në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr.188, datë*

28.05.2020, sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit

19.1 Pas përfundimit të afatit të ankimit, ndaj vendimit të mësipërm, në përgjigje të kërkesës së Këshillit, Gjykata Administrative e Apelit Tiranë me shkresën nr. 325 prot. datë 02.11.2020 ka konfirmuar se ndaj vendimit nr. 398 datë 28.05.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor nuk është ushtruar ankim nga palët e interesuara dhe për rrjedhojë kandidatja {...} vijon kandidimin e saj për ngritjen në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit, vetëm për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr. 187, datë 28.05.2020 të Këshillit.

20. Sipas pikës 9, të Vendimit të Këshillit nr. 187, datë 28.05.2020, është përcaktuar se: “Për kandidatin, për të cilin me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor verifikohet plotësimi i kriterëve ligjore të kandidimit sipas shkronjave “a”, “c” dhe “ç”, të pikës 5, të këtij vendimi, fillon menjëherë procesi i vlerësimit etik dhe profesional: ...”. Ndërkohë, në pikën 5, shkronja “a”, të Vendimit të Këshillit nr. 187, datë 28.05.2020, përcaktohet se: “Kriteret ligjore që duhet të plotësojë kandidati për t’u ngritur në detyrë pranë gjykatës së shkallës së dytë përcaktohen..., si më poshtë: a) Kandidati duhet të ketë ushtruar ushtruar funksionin jo më pak se shtatë vjet në shkallën e parë, nga të cilat të paktën pesë vjet në fushën e së drejtës administrative, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar”. Nga ana tjetër, në shkronjat “c” dhe “ç”, të pikës 5, të këtij vendimi, përcaktohet se: “c) Kandidati duhet të mos ketë masë disiplinore në fuqi; ç) Kandidati duhet të mos jetë në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”.

21. Në respektim të vendimit si më lart të Këshillit, sa i përket plotësimit të tre kriterëve formale të sipërpërmendura të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit, me qëllim realizimin paralelisht edhe të procedurave të vlerësimit etik dhe profesional të kandidatëve, pra në funksion të përmbylljes sa më parë të procedurave të kandidimit, për kandidaten znj. {...} u kërkua dhe u administrua informacioni i nevojshëm nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, si organi kompetent për krijimin dhe administrimin e dosjeve personale dhe regjistrin të gjyqtarëve, si dhe nga gjykatat ku kandidatja ka ushtruar funksionin e gjyqtares.

21.1 Për verifikimin e kriterëve të “përvojës profesionale minimale” dhe atij të “mospasjes masë disiplinore në fuqi”, Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, me Shkresën nr. 3189/1 prot., datë 13.07.2020, përcolli informacionin dhe dokumentacionin përkatës të administruar për kandidaten znj. {...}, siç do të përshkruhet më poshtë.

21.2 Sa i përket kriterit të “përvojës profesionale minimale” dhe pikërisht nënkriterit të “përvojës specifike profesionale” të kandidatës në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë ku ajo ka kandiduar, pra në fushën e të drejtës administrative, referuar gjykatave ku kandidatja ka ushtruar funksionin e gjyqtares, konkretisht në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë dhe pas datës 04.11.2013 në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, informacioni iu kërkua Gjykatës së Rrethit Gjyqësor

Tiranë dhe Lushnjë, ndërsa është e qartë përvoja e kandidatës në fushën e të drejtës administrative në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë informacioni i kërkuar është përcjellë me Shkresën nr. 4649/1 prot., datë 17.07.2020, siç do të përshkruhet më poshtë.

Nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë informacioni i kërkuar është përcjellë me Shkresën nr. 234 prot., datë 16.07.2020, siç do të përshkruhet më poshtë.

II. REZULTATET E VERIFIKIMIT PARAPRAK PËR TRE KRITERET E KANDIDIMIT

22. Për kandidaten znj. {...} u verifikua kriteri i “përvojës profesionale minimale”.

23. “Përvoja profesionale minimale” për ngritjen në detyrë në gjykatën e shkallës së dytë në rastin konkret në Gjykatën Administrative të Apelit, që gjën reflektim në shkronjën “a”, të pikës 5, të Vendimit të Këshillit nr. 187 datë 28.05.2020, është parashikuar si kusht kandidimi në nenin 47, pika 4, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: *“Magjistrati mund të ngrihet në detyrë në pozicione pranë gjykatave ose prokurorive të shkallës së dytë, nëse ka ushtruar funksionin jo më pak se shtatë vjet në shkallën e parë, nga të cilat të paktën pesë vjet në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar”.*

24. Për verifikimin e kandidatës në lidhje me plotësimin e këtij kriteri për ngritjen në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit u mbajt parasysh se në këto gjykata gjykohen çështje me lëndë administrative, çka do të thotë se kandidatja, krahas përvojës së përgjithshme profesionale minimale, që është jo më pak se shtatë vjet, duhet të plotësojë edhe përvojën specifike profesionale minimale, pra jo më pak se pesë vjet në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionet e lira, konkretisht në fushën e të drejtës administrative për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 187, datë 28.05.2020.

25. Në lidhje me përvojën e përgjithshme profesionale, në kërkesat për shprehje interesi dhe në jetëshkrimin e dorëzuar nga kandidatja, evidentohet se ajo ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2007. Kandidatja ka kryer stazhin profesional si gjyqtare në kuadër të vitit të tretë të Shkollës së Magjistraturës në vitet 2006-2007 pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Më pas, ajo është emëruar përfundimisht gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, ku ka ushtruar funksionin për periudhën 14.11.2007 – 04.11.2013. Nga data 04.11.2013, ajo ushtron funksionin e gjyqtarës në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

26. Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjellë nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, kandidatja znj. {...}, fillimin në detyrë e ka me Dekretin e Presidentit të Republikës nr. 5045 datë 04.10.2006, ku është emëruar për të kryer stazhin profesional në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ndërsa me Dekretin e Presidentit të Republikës nr. 5515 datë 14.11.2007, ajo është emëruar përfundimisht gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë. Më pas, me Dekretin e Presidentit të Republikës nr. 8247 datë 16.07.2013, dekret i cili ka hyrë në fuqi me datën 04.11.2013, ajo është emëruar gjyqtare në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, ku vijon të ushtrrojë funksionin dhe aktualisht.

27. Nga të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, Këshilli vlerëson se kandidatja znj. {...}, deri në momentin e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën

Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 187, datë 28.05.2020, rezulton të ketë mbi shtatë vjet përvojë të përgjithshme profesionale si gjyqtare e gjykatës së shkallës së parë.

28. Në lidhje me përvojën specifike profesionale, në kërkesën për shprehje interesi, kandidatja ka deklaruar se ka eksperiencë të mjaftueshme në fushën e të drejtës administrative prej më shumë se 5 vjetësh.

29. Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjellë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, rezulton se:

“... znj. {...}, fillimin në detyrë e ka me Dekretin nr. 5045, datë 04.10.2006, ku është emëruar për të kryer stazhin profesional pranë kësaj gjykate deri më 14.11.2007.

Në lidhje me sa kërkoni, për periudhën kohore për të cilën kërkohet informacioni për përvojën e gjyqtares znj. {...}, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, nuk disponon urdhra të Kryetarit për ndarjen në dhoma/seksione të gjyqtarëve.

Në mungesë të tyre, bashkëngjitur kësaj shkrese, gjeni në format statistikor, llojet e vendimeve gjyqësore të dhëna nga gjyqtare znj. {...}, për periudhën 2006-2007...”.

30. Referuar të dhënave të regjistrit të vendimeve civile për vitin 2006 - 2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, kandidatja znj. {...}, referuar objektit të çështjeve gjyqësore, është shortuar dhe ka gjykuar *çështje të karakterit administrativ, civil dhe penal.*

31. Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjell nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, rezulton se:

“...Gjyqtarja {...}, me Dekretin nr. 5515, datë 14.11.2007 të Presidentit të Republikës është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë dhe është transferuar në datë 04.11.2013.

Rezulton se gjatë kësaj periudhe ajo ka gjykuar bazuar në urdhrat përkatës të kryetarit të gjykatës për vitin 2008 në seksionin civil të përgjithshëm, në vitin 2009 – 2010 në seksionin administrativ, në vitin 2011 – 2012 në seksionin administrativ, në vitin 2013 ka gjykuar çështje të karakterit civil, administrativ dhe penal pasi nuk ka patur ndarje në seksione gjykata.

Gjithashtu theksohet fakti se pavarësisht së gjykata ka qenë e ndarë në seksione, të gjyqtarët kanë gjykuar me short çështjet penale ..”.

31.1 Referuar të dhënave të mësipërme për vitin 2007 - 2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, kandidatja znj. {...}, ka gjykuar *çështje të karakterit administrativ, civil dhe penal.*

32. Ndërkohë referuar të dhënave, rezulton se kandidatja znj. {...}, nga data 04.11.2013 dhe në vijim, është gjyqtare pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, e për rrjedhojë që nga kjo datë ajo gjykon vetëm çështje me lëndë administrative.

33. Nga të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, Këshilli vlerëson se kandidatja znj. {...}, deri në momentin e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 187, datë

28.05.2020, rezulton të ketë mbi pesë vjet përvojë profesionale në fushën e të drejtës civile dhe administrative.

34. Për kandidaten znj. {...} u verifikua edhe kriteri i “mospasjes masë disiplinore në fuqi”.

35. “Mospasja masë disiplinore në fuqi” si kriter për ngritjen në detyrë edhe në gjykatën e shkallës së dytë, që gjen reflektim në shkronjën “c”, të pikës 5, të Vendimit të Këshillit nr. 187, datë 28.05.2020, është parashikuar në nenin 48, pika 8, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: *“Vetëm kandidatët të cilët ... nuk kanë masa disiplinore në fuqi, pranohen në procedurat e mëtejshme të ngritjes në detyrë”.*

36. Në lidhje me këtë kriter, në rastin e aplikimit, kandidatja ka depozituar formularin e Vetëdeklarimit “Për masa disiplinore” datë 12.06.2020, nëpërmjet të cilës, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, ka deklaruar se: *“Nuk kam masë disiplinore në fuqi”.*

37. Sipas informacionit të përcjellë nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, kandidatja znj. {...} nuk ka masa disiplinore në fuqi.

38. Nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, Këshilli vlerëson se nuk vërtetohet që kandidatja znj. {...} të ketë masë disiplinore në fuqi.

39. Për kandidaten znj. {...} u verifikua edhe kriteri i “papajtueshmërisë ambientale”.

40. Papajtueshmëria ambientale si kriter ndalues për ngritjen në detyrë edhe në gjykatën e shkallës së dytë, që gjen reflektim në shkronjën “ç”, të pikës 5, të Vendimit të Këshillit nr. 187, datë 28.05.2020, është parashikuar në nenin 8, pika 2, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: *“Këshillat, gjatë ... ngritjes në detyrë të magjistratit, për aq sa është e mundur dhe pa cenuar në mënyrë joproporcionale të drejtën për zhvillimin normal të karrierës profesionale të magjistratit, marrin masa për të shmangur papajtueshmërinë ambientale, sipas pikës 3, të këtij neni, me qëllim që të garantohet besimi i publikut në sistemin e drejtësisë, pavarësia dhe paanësia e magjistratit, eficienta e gjykatave dhe zyrave të prokurorisë në dhënien e drejtësisë”.* Ndërkohë, kuptimi i papajtueshmërisë ambientale përcaktohet në pikën 1, të kësaj dispozite ligjore, sipas të cilës: *“Papajtueshmëria ambientale, në kuptimin e këtij neni, krijohet për shkak të lidhjeve të ngushta familjare mes magjistratëve, që janë përkatësisht bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, ose të afërmit e tij deri në shkallë të dytë”.* Sa i takon rasteve të papajtueshmërisë ambientale për sa lidhet me ngritjen në detyrë në gjykatën e shkallës së dytë, ato parashikohen në pikën 3, shkronja “a”, të kësaj dispozite ligjore, ku përcaktohet se: *“Papajtueshmëri ambientale përbëjnë rrethanat e mëposhtme: a) nëse respektivisht në të njëjtën gjykatë ose prokurori ku magjistrati kërkon të caktohet, ushtron funksionin një magjistrat tjetër, që ndodhet në kushtet e pikës 1 të këtij neni”.*

41. Në lidhje me papajtueshmërinë ambientale, në rastin e aplikimit, në përputhje me detyrimin sipas nenit 8, pika 5, të Ligjit për Statusin, kandidatja ka depozituar formularin e Vetëdeklarimit “Për situatën e papajtueshmërisë ambientale” datë 12.06.2020, nëpërmjet të cilës, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, ka deklaruar se: *“Nuk do të ndodhem në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”.*

42. Gjatë verifikimit nuk rezultoi ndonjë e dhënë e ndryshme nga ajo e deklaruar nga kandidatja në lidhje me situatën e papajtueshmërisë ambientale për sa ajo kandidon për ngritjen në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit.

43. Nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, Këshilli vlerëson se për kandidaten znj. {...} nuk vërtetohet të ndodhet në situatën e papajtueshmërisë ambientale në rast të ngritjes në Gjykatën Administrative të Apelit.

III. KONKLUSIONE

44. Referuar kërkesave të Vendimit 75/2019, duke mbajtur parasysh edhe përcaktimet e Vendimit nr. 187, datë 28.05.2020, nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar gjatë procedurës së verifikimit paraprak të tre kriterëve formale të kandidimit të znj. {...}, për ngritjen në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se procedura e verifikimit e ndjekur në këtë rast është e plotë dhe në përputhje me ligjin.

45. Bazuar në sa më lart është parashtruar mbi rezultatet e verifikimit paraprak të tre kriterëve formale të kandidimit për kandidaten znj. {...}, konkretisht të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se kandidatja i plotëson ato, ndërsa nuk ekziston ndonjë shkak për skualifikimin e saj nga kandidimi në lidhje me këto kriterë. Nisur nga kjo, Këshilli çmon se është vendi për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit, të tre kriterëve të sipërpërmendura të kandidimit dhe vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatës për kriteret e tjera ligjore në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë, të shpallur me Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 187, datë 28.05.2020

PËR KËTO ARSYE

Mbështetur në pikën 3, të nenit 136, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 8, në pikën 5, të nenit 47, në pikën 8, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimin e tij nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, si dhe në pikën 9, të Vendimit të tij nr. 187, datë 28.05.2020, “Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës Administrative të Apelit”, Këshilli i Lartë Gjyqësor,

VENDOSI:

1. Verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 187, datë 28.05.2020 të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidates për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 187, datë 28.05.2020.
3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidates znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqjen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR